

FORUMI
për
SIGURI

ZBATIMI “POLITIK” I LIGJIT NË KOSOVË

Prishtinë, Prill 2011

Forumi për Siguri Raport vlerësues

Zbatimi “Politik”i ligjit në Kosovë

Autorët

Valdrin Grainca

Skender Përteshi

Asistentë të hulumtimit:

Florentina Hajdari

Sofije Kryeziu

Forumi për Siguri falënderon Grupin Këshillues të ekspertëve të Forumit për Siguri për kontributin profesional dhe kualitativ që dhanë në hartimin e këtij raporti vlerësues :

© Të drejtat autoriale

Asnjë pjesë nga ky publikim nuk mund të riprodhohet apo të ndryshohet pa lejen e botuesit. Mendimet e shprehura me shkrim apo në publikimet elektronike janë të Forumit për Siguri dhe nuk përfaqësojnë pikëpamjet e organizatës Balkan Trust for the Democracy (BTD) që është edhe financues i këtij raporti.

Forumi për Siguri (FS) është themeluar në qershor të vitit 2010 me iniciativën e dy organizatave vendore, Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ) dhe Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (KCSS).

FS do të shërbej si platformë për organizatat e shoqërisë civile, media, akademikët, studentët dhe institucionet për të diskutuar çështjet kyçe të sigurisë dhe për të shkëmbyer e zhvilluar përvojat dhe praktikat më të mira në fushën e sigurisë në Kosovë.

Ky është raportit i tretë me radhë i FS, pas raporteve “Sektori i sigurisë në Kosovë pas Pavarësisë”, dhe “Menaxhimi i Integruar i kufirit në Kosovë” publikuar në nëntor 2010 dhe janar 2011.

PËRMBAJTJA

Lista Shkurtesave	4
PARATHËNIA	5
HYRJE	6
QASJA E INSTITUCIONEVE DHE PRANISË NDËRKOMBËTARE NDAJ SFIDAVE NË VERI TË KOSOVËS	7
Rastet për Studim:	10
<u>Veturat pa targa</u>	10
Funksionimi I zinxhirit komandues në Policinë e Kosovës	12
Strukturat ilegale.....	13
Analizë	14
Rekomandimet.....	16
Bibliografia:	18

LISTA SHKURTESAVE

BE – Bashkimi Evropian

BIA-Sherbimi Inteligent i Serbisë

DK – Dogana e Kosovës

EULEX – Misioni i BE për Sundimin e Ligjit të Kosovë

FS – Forumi për Siguri

FSK- Forca e Sigurisë së Kosovës

ICG – Grupi Ndërkombëtar i Krizave

ICO – Zyra Civile Ndërkombëtare

KFOR – Forca për Kosovën

MD – Ministria e Drejtësisë

MMK – Mentorim, Monitorim dhe Këshillim

MPB – Ministria e Punëve të Brendshme

MUP – Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë

MV – Mitrovica e Veriut

PK – Parlamenti i Kosovës

PK – Policia e Kosovës

PKK – Pikat e Kalimit Kufitar

QAKE – Qendra Alarmuese dhe Koordinuese Emergjente

QK – Qeveria e Kosovës

UNMIK – Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

PARATHËNIA

Që nga përfundimi i luftës në vitin 1999, e deri në ditët e sotme, në Kosovë është e debatueshme nëse janë vendosur themelet e shtetit të mirëfilltë demokratik. Kjo përveç tjerash, për shkak të sfidave rreth ndarjes së pushteteve dhe funksionimit të pavarur të tyre.

Që atëherë, konfuzioni rreth mandatit për qeverisjen dhe vendimmarrjen në Kosovë, ka çuar në mungesën e llogaridhënies si nga institucionet ndërkombëtare ashtu edhe ato të Kosovës, duke lënë hapësirë për “hedhje të fajit” nga njëra palë tek tjetra, si nga ndërkombëtarët tek vendorët dhe anasjelltas.

Megjithëse, misioni i UNMIK-ut të atëhershëm dhe misioni i tanishëm i EULEX kanë pasur për synim ndarjen e pushteteve, sidomos krijimin e një gjyqësori të pavarur, zbatimin efektiv të ligjit dhe funksionimin transparent e demokratik të institucioneve, kjo edhe në ditët e sotme duket më shumë një synim ambicioz.

Nga raportet e ndryshme ndërkombëtare e vendore, krijohet përshtypja që në Kosovë është më e arsyeshme të flitet për gjyqësor, se sa për drejtësi, jo vetëm për faktin që në Kosovë ende ekzistojnë mbi 200,000 lëndë të pa zgjidhura (të grumbulluara që nga pas lufta), por edhe për shkak të mungesës së sigurisë dhe zbatimit të ligjit në veri të vendit. Për më shumë, zhvillimet e fundit lidhur me dyshimet për krime, si ato për korrupsion, apo ato të kryera gjatë luftës, duket se bëhen nën udhëzimet politike, si në Kosovë, ashtu edhe jashtë kufijve të saj. Këto mund të ilustrohen përmes paraqitjeve (kohëve të fundit) të shpeshta publike, sidomos nga EULEX-i dhe retorikës për luftim të korrupsionit, krimin të organizuar dhe sjelljes para drejtësisë “të peshqve të mëdhenj”, e deri tek raporti i fundit mbi dyshimet për krime lufte i lëshuar nga një trup politik në Bruksel.

Si pasojë e mos zbatimit të ligjit, nga hulumtimet e shumta del që besimi i qytetarëve gjatë gjithë kohës vazhdon të jetë i ulët, sidomos në institucionet qendrore, gjyqësor dhe EULEX. Situata e tillë mund të ketë ndikuar opinionin publik, përfshi edhe atë ndërkombëtar, që qytetarët e Kosovës nuk e respektojnë dhe nuk i nënshtrohen ligjit. Për më shumë, është krijuar përshtypja që në Kosovë, populli, në vend se politika, është i dështuar. Mirëpo, duhet pas parasysh që në zhvillimin politik dhe demokratik të vendit, përgjegjësi dhe merita kanë jo vetëm klasa politike e Kosovës, por edhe faktori ndërkombëtar, qoftë përmes vendosjes së administratës nga viti '99 deri në shpalljen e pavarësisë, qoftë përmes vazhdimit të mbështetjes politike dhe financiare pas pavarësisë.

Me gjithë investimet e mëdha nga organizmat ndërkombëtar me synim në ndërtimin e një sistemi të avancuar gjyqësor, gjyqësori nuk duket të jetë në gjendje më të mirë se sa që ishte njëmbëdhjetë vjet më parë, përkundër një progresi shumë të kufizuar. Këto në fakt mund të jenë pasoja që vijnë nga reformat e zvarritura dhe të politizuara në gjyqësi, mungesës së hartimit të një ligji të zbatueshëm, në vend të ligjeve të aplikueshme, si dhe dualizmit të theksuar në mes të institucioneve të Kosovës dhe atyre ndërkombëtare në zbatim të ligjit. Ndërsa, Kuvendi i Kosovës ka dështuar të organizoj debate

parlamentare rreth sfidave të sigurisë në Kosovë, e me këtë edhe të ushtrimit të kontrollit demokratik ndaj institucioneve të Kosovës përgjegjëse për siguri. Për më shumë, veriu i Kosovës, nuk ka zënë vend ndonjëherë në rendin e ditës të seancave parlamentare.

Në Kosovë për njëmbëdhjetë vite me radhë nuk dihet qartë se kush është vendimmarrës, si mundësohet përdorimi i diskrecionit dhe subjektivitetit në çështjet e sigurisë dhe drejtësisë për shkak të ekzistimit të ligjeve të ndryshme të aplikueshme, dhe si funksionon prania shumë e kushtueshme ndërkombëtare me mandate të paqarta.

Rrjedhimisht, gjendja e tillë po rezulton në krijimin e përshtypjes se zbatimi i ligjit në Kosovë është i ndikuar nga politika dhe zhvillimet politike në Kosovë, rajon dhe më gjerë.

Nga kjo del që synimi i vetëm i klasës politike dhe faktorit ndërkombëtar në Kosovë, mbetet stabiliteti. Pra, një 'status quo', pasojat e së cilës shumë shpejt mund ta vënë në pikëpyetje këtë "stabilitet".

HYRJE

Ky është raporti i tretë me radhë i Forumit për Siguri, i ndërmarrë në periudhën janar-prill 2011, dhe ka për qëllim të analizoj politikën, qasjen dhe veprimet e institucioneve të Kosovës dhe pranisë ndërkombëtare në Kosovë lidhur me efektivitetin e zbatimit të ligjit në fushën e sigurisë, me theks të veçantë në veriu të Kosovës.

Hartimi i këtij raporti është bazuar në metoda kualitative, që përfshinë analizën e dokumenteve siç janë ligjet, strategjitë, raportet e organizatave dhe institucioneve ndërkombëtare dhe vendore, burimet e medie, si dhe zhvillimi i intervistave të drejtpërdrejta me akterët përkatës dhe observimit përmes pjesëmarrjes në takime dhe konferenca të ndryshme.

Raporti synon të kontribuojë drejt zhvillimit të politikave të përshtatshme dhe veprimeve konkrete në zbatimin e ligjit për gjithë qytetarët pa përjashtim në tërë territorin e Kosovës. Gjithashtu, raporti synon të nxisë institucionet e Kosovës dhe prania ndërkombëtare që të ndryshojnë qasjen e tyre dhe të ndërmarrin veprime që e ndryshojnë status quo-në e tanishme dhe çojnë drejt vendosjes së rendit dhe ligjit, si një prej parakushteve themelore për ndërtimin e paqes së qëndrueshme dhe prosperitetit në Kosovë.

Në fokus të këtij raporti është ofrimi i sigurisë dhe zbatimi i ligjit në veri të Kosovës përmes shtjellimit të tri çështjeve të njohura për opinionin siç janë vetura pa targa, zinxhiri (jo-unik) komandues i policisë dhe strukturat ilegale në Kosovë.

Këto tri çështje janë shtjelluar për të ilustruar praktikisht gjendjen e sigurisë dhe zbatimin e ligjit në veri të Kosovës. Megjithatë, situata mbetet e njëjtë edhe sa i përket funksionimit të doganave, vjeljes së taksave, arsimit dhe sektorëve tjerë.

Të gjeturat e këtij raporti, të paraqitura më poshtë, janë shqetësuese dhe kërkojnë veprime konkrete, jo të balancuara, e aq më pak selektive dhe të politizuara, nga institucionet e Kosovës dhe ato ndërkombëtare.

Të gjeturat kryesore:

- Ekzistimi i ligjeve të aplikueshme mundëson përdorimin e diskrecionit dhe subjektivitetit në zbatimin e ligjit;
- Vazhdimi i pranisë ndërkombëtare nën rezolutën 1244 të KS të OKB-së dhe mungesa e ri-konfigurimit të kësaj pranie për të qenë në përputhje me realitetin dhe rrethanat e krijuara pas shpalljes së pavarësisë është duke krijuar konfuzion, pakënaqësi dhe mosbesim në mesin e qytetarëve të Kosovës;
- Mungesa e një agjende të përbashkët për të ardhmen e Kosovës, si dhe mungesa e vullnetit politik për bashkërendim dhe bashkëpunim në mes të institucioneve të Kosovës dhe pranisë ndërkombëtare për luftimin e krimit, korrupsionit dhe zbatimin e ligjit në Kosovë;
- Mos transferimi i kompetencave (në veri të Kosovës) nga faktori ndërkombëtar në Policinë e Kosovës, ka shkaktuar shkëputjen e zinxhirit unik komandues të policisë që bie në kundërshtim të drejtpërdrejtë me kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës;
- Veprimi i strukturave ilegale serbe në tërë territorin e Kosovës, veçanërisht në veri dëshmon për progresin e kufizuar dhe mungesën e vullnetit politik dhe të vendosmërisë si nga ana e institucioneve të Kosovës, ashtu edhe të atyre ndërkombëtare për të ofruar siguri, rend dhe ligj për të gjithë qytetarët e Kosovës, pa marrë parasysh vendbanimin dhe përkatësinë etnike;
- Mos ekzistimi i gjykatave të Kosovës në veri pamundëson veprimet e policisë në zbatimin e ligjit dhe pamundëson qasjen në drejtësi për qytetarët;

QASJA E INSTITUCIONEVE DHE PRANISË NDËRKOMBËTARE NDAJ SFIDAVE NË VERI TË KOSOVËS

QEVERIA E KOSOVËS

Që nga pas lufta e deri më sot roli i pranisë ndërkombëtare mbetet pothuajse përcaktues në zhvillimin e sektorit të sigurisë dhe drejtësisë, e me këtë edhe në vendosjen dhe forcimin e sundimit të rendit dhe ligjit në Kosovë. Mirëpo, e tërë kjo periudhë kohore karakterizohet me mungesë të qartësisë sa i përket

përgjegjësi të institucioneve të Kosovës dhe pranisë ndërkombëtare. Përveç tjerash, kjo paqartësi mund të ilustruhet përmes rastit të nënshkrimit të marrëveshjes (protokollit) policore në mes të EULEX dhe MUP-it të Serbisë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Nënshkrimi i kësaj marrëveshje është bërë pas miratimit të planit 6 pikësh të KS të OKB-së për Kosovën, gjë që është kundërshtuar fuqishëm nga institucionet, shoqëria civile dhe qytetarët e Kosovës. Kjo pakënaqësi është shoqëruar me protesta masive në Kosovë.

Pavarësisht nga rrethanat e krijuara pas shpalljes së pavarësisë dhe njohjes nga 76 shtete, anëtare të OKB, nga këto 22 shtete anëtare të BE, dhe vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në të cilën thuhet se miratimi i deklaratës së pavarësisë së Kosovës me 17 shkurt 2008 nuk ka qenë në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare, rezolutën 1244 të KS të OKB-së apo Kornizën Kushtetuese¹, prania ndërkombëtare vazhdon të ushtroj mandatin e vet nën rregullimin e njëjtë (rezolutën 1244 të KS të OKB) si në vitin 1999 që shënoi përfundimin e luftës në Kosovë.

Mungesa e qartësisë së mandatit të misionëve ndërkombëtare, veçanërisht EULEX dhe UNMIK, si dhe mungesa e një strategjie nga institucionet e Kosovës për t'i trajtuar sfidat në veri, ka krijuar hapësirë të madhe dhe klimë të favorshme për strukturat ilegale të cilat e kanë shfrytëzuar për të forcuar edhe më shumë ndikimin e tyre në Kosovë. Kjo situatë mund të ilustruhet nga nxjerrja jashtë funksionit të pikave doganore 1 dhe 31, si dhe mbylljes së gjykatës në veri, menjëherë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës.

Me shpalljen e pavarësisë së Kosovës, rendi i ri kushtetues nuk u njoh nga pakica serbe, duke bërë që zyrtarët policor serb në policinë e Kosovës të braktisin punën e tyre. Ndonëse, edhe pas kthimit në policinë e Kosovës (rreth një vit më vonë), pjesëtarët serbë në policinë e Kosovës nuk njohën realitetin e ri. Tani, EULEX shfrytëzohet si pikë lidhjeje me Policinë e Kosovës. Ndërsa, shërbimet tjera komunale në veri ofrohen nga strukturat ilegale si dhe Zyra e UNMIK-ut për administrim, në pjesën veriore të Mitrovicës. Kjo dëshmon mungesën e shtrirjes së rendit kushtetues të Republikës së Kosovës dhe nga ky vakum kanë përfituar grupet e krimit të organizuar duke realizuar fitime të mëdha materiale dhe ndikim politik në Kosovë.

Duke pasur parasysh dominimin e një shtete të tillë, Qeveria e Kosovës në bashkëpunim me Zyrën Ndërkombëtare Civile (ICO) në Kosovë hartoi Strategjinë për veriun e Kosovës, strategji e cila qartëson politikën qeveritare kundrejt këtij problemi. Synimi i kësaj strategjie është shtrirja dhe forcimi i institucioneve të zbatimit të ligjit në gjithë territorin e Kosovës duke përfshirë veriun si dhe krijimin e mekanizmave të qeverisjes dhe përmirësimit të situatës sociale dhe ekonomike.² Në këtë dokument, përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë për secilin aktor. Kështu, ICO duhet të ndihmojë në themelimin e Komunitetit të Mitrovicës Veriore ndërsa EULEX duhet të ushtroj rolin e vet në përmirësimin e situatës së sigurisë dhe funksionalizimin e gjyqësorit dhe doganave. Megjithatë, këto institucione kanë dështuar të ofrojnë siguri për qytetarët dhe krijimin e bazës për qeverisje lokale. Pra, këtu vihen në dyshim edhe

¹ INTERNATIONAL COURT OF JUSTICE: <http://www.icj-cij.org/docket/files/141/15987.pdf>

² Strategy for Northern Kosovo, 15.01.2010, faqe 1.

vete kapacitetet e EULEX për të vendosur rend dhe ligj në veriun e vendit. Në pamundësi për të krijuar një klimë të favorshme për kthimin e gjykatave në veri, EULEX mundohet që këtë ta zhvendos në procesin e dialogut që po zhvillohet e cila është shkelje e sovranitetit dhe integritetit shtetëror³.

Si pasojë, nuk është bërë asgjë në mënjanimin e veturave pa targa nga trafiku, zinxhiri komandues i policisë funksionon vetëm me ndërmjetësim të EULEX, ndërsa strukturat ilegale (ku disa prej te cilave madje edhe i vjelin taksa nga taksapaguesit, si p.sh. Elektro - Serbia) funksionojnë pa ndonjë vështirësi.

Edhe pas tërë këtyre viteve, Kosova vazhdon të ketë legjislacion të miratuar nga autoritete të ndryshme madje edhe kundërthënës. Kjo përfshinë legjislacionin e miratuar në periudhën e ish-Jugosllavisë, rregulloret dhe rezolutat e misionit të OKB-së (UNMIK-ut), si dhe legjislacionin e miratuar nga Qeveria e Kosovës. Vlen të theksohet që përkundër aprovimit të ligjeve të Republikës së Kosovës, disa nga rregulloret e UNMIK vazhdojnë të jenë në fuqi apo jo të gjitha rregulloret e nxjerra nga UNMIK janë shfuqizuar.

EULEX

Për EULEX-in çështja e veriut është prioritet i lartë dhe për këtë është duke u rritur stafi i këtij misioni.⁴ Strategjia e këtij misioni bazohet në katër komponentë⁵: 1) me vendosjen e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicën veriore, 2) ri-vendosjen e kontrolleve doganore në pikat e kalimit kufitar Bërnjak dhe Jarinjë ose (1 dhe 31,), 3) mbështetjen e policisë lokale nënën stacionet policore të Komunave veriore të Kosovës duke përfshirë Zveqan, Zubinpotok, Stacionin verior në Mitrovicë dhe Leposavic , dhe 4) ushtrimin të kompetencave ekzekutive për sundimin e ligjit *“atëherë kur është e nevojshme”*. Qasja e EULEX-it ndaj veriut të vendit konsiston në qasje sistematike duke adresuar ndjeshmërinë e situatës politike dhe pasojat të cilat mund të shkaktohen nga veprimet e ndryshme e që kanë të bëjnë me vënien e rendit dhe ligjit në harmoni me legjislacionin shtetëror të Kosovës.⁶

Kjo ndjeshmëri vërehet në shumë raste. Në përgjithësi, sipas gjetjeve të këtij hulumtimi, qasja e tillë *“frenuese”* e EULEX-it dhe mungesa e rezultateve konkrete pamundëson zbatimin e ligjit në këtë pjesë. Argumenti i vazhdueshëm reflekton një retorikë për *“stabilitet të ekzagjeruar”* që nuk dallon shumë nga prania ndërkombëtare në Kosovën e para-pavarësisë.

Edhe pse EULEX i referohet krijimit të një task force (EULEX TASK Force Mitrovica) për luftimin e krimit të organizuar, kjo nuk dha ndonjë veprim praktik që vlen të përmendet. Kjo TASK FORCE përbëhet nga hetues policor, gjyqtar dhe prokurorë të EULEX e cila është krijuar në nëntor të vitit 2010 e cila synon luftimin e krimit të organizuar si dhe vendosjen e rendit dhe ligjit në veri. Në një vizitë në veri të vendit, shefi i EULEX de Marnhac deklaroi se prioritet i tij është rritja e prezencës së EULEX-it me qëllim të

³ <http://www.kohaditore.com/index.php?cid=1,22,56011>

⁴ Intervistë me Iaan Cohn koordinator për veriun nga EULEX. 23 shkurt 2011.

⁵ Roy Reeve, Zëvendës/shef i Misionit të Eulexit, *“Four steps to security and stability”*, 16 korrik 2010, shih: <http://www.eulex-kosovo.eu/en/neës/000245.php>

⁶ Intervistë me Alessandro Tedesco, menaxher i programeve nga EULEX-i për shoqërinë civile, 23 shkurt 2011

luftimit të krimit të organizuar në veri.⁷ Ndonëse, gjendja atje paraqet dështim në ndërmarrjen e veprimeve në terren.

ZYRA NDËRKOMBËTARE CIVILE (ICO)

Edhe pse Plani i Presidentit Ahtisari si pjesë përbërëse e kushtetutës është duke u zbatuar, për çka rrolin mbikëqyrës për zbatimin e këtij plani e ka ICO, në faqen zyrtare të internetit të ICO-së thuhet se ICO është e ngarkuar nga Grupi Drejtues Ndërkombëtarë (ISG) që të garantojë se Qeveria e Kosovës zbaton Propozimin Gjithëpërfshirës të Zgjidhjes së Statusit.⁸ Siç mund të vërehet, përkundër që plani i Presidentit Ahtisari është bërë i zbatueshëm në Kosovë, ky plan nga ICO ende quhet “propozim për zgjidhjen...”.

Ndonëse, ICO dhe Qeveria e Kosovës ishin bartës të strategjisë për veriun, ndërsa kjo e para edhe përgjegjëse për krijimin e komunës së Mitrovicës Veriore, në të dy rastet mund të konstatohet se ka pasur dështim në realizim.

RASTET PËR STUDIM:

Ndër sfidat kryesore në veri të vendit janë mos-ekzistimi i institucioneve të Kosovës (gjykatave, administratës komunale, doganave, institucioneve shëndetësore dhe arsimore), veprimtaria e strukturave ilegale dhe funksionimi i misioneve ndërkombëtare nën mandatin e dhënë nga rezoluta 1244 e KS të OKB-së.

Më poshtë ne do të paraqesim vetëm tre nga këto për të përshkruar përmes shembujve praktik gjendjen reale në veri të vendit, por gjendja është e njëjtë edhe ne sektorët tjerë.

VETURAT PA TARGA

Në bazë të ligjit për sigurinë e transportit rrugor, automjetet në qarkullim pa targa paraqesin kundërvajtje dhe dënime për këtë kapin vlerën 35 euro. Po ashtu, personat që nuk regjistrojnë automjetet e tyre mund të gjobiten me 200 €uro.⁹ Deri më tani, janë vetëm tri lloje të targave të lejueshme në qarkullim: targat nga koha e Jugosllavisë (deri më 1999), targat nga periudha e UNMIK-ut, dhe targat e lëshuara së fundi nga Republika e Kosovës. Ndërsa, tani i vetmi autoritet përgjegjës për regjistrim dhe dhënie të targave është Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës.

⁷ De Marnhac, emphasizes the importance of the north of Kosovo, 05 Nov 2010, shih: <http://www.eulex-kosovo.eu/en/news/000266.php>

⁸ Ueb faqja e ICO: <http://www.ico-kos.org/ico/?id=9>, shikuar me datë 22 prill 2011

⁹ Ligji Nr.02/L-70, Për sigurinë në komunikacionin rrugor. 11 janar 2007. Shih: <http://www.mtpt.org/data/docs/laws/Ligji.pdf>

Përkundër faktit që ka legjislacion që rregullon komunikacionin dhe sigurinë rrugore dhe se autoriteti përgjegjës për ndëshkimin e kundërvajtësve është policia e trafikut rrugor, në veri të vendit ende ka qarkullim të automjeteve të paregjistruara dhe pa targa. Policia e trafikut rrugor ka raste që ka gjobitur shoferët që kanë pasur vetura pa targa dhe të paregjistruara.¹⁰ Mirëpo, këto raste janë të rralla dhe eliminimi i problemit nuk ka ndodhur. Shkeljet e vogla të natyrës së kundërvajtjes janë problematike në rajonin e Mitrovicës.¹¹ Në këtë kategori hyjnë edhe veturat pa targa e të pa regjistruara. Në rrafshin e luftimit të krimit, veturat e paregjistruara vështirësojnë identifikimin e kryerësve të veprave penale. Përveç faktit që policia e Kosovës nuk ka tentuar të heqë nga qarkullimi veturat e tilla, edhe gjykatat nuk veprojnë për të përfunduar lëndët e caktuara. Edhe nëse policia gjobitë shkelësit e ligjit, këto gjopa do të mbesin si të tilla ngase gjykatat nuk funksionojnë.¹²

Veturat pa targa janë pasojë e mosbindjes së serbëve të Kosovës ndaj autoritetit që lëshon targat, si dhe mos kryerjes së punës nga policia, prokuroria dhe gjykata. Targat e përkohshme të lëshuara nga UNMIK-u nuk janë pranuar nga qytetarët serb të Kosovës, ndërkaq të njëjtin fat e kanë pasur edhe targat e lëshuara nga Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës.

Një mundësi e re për ta, ishin targat e lëshuara nga Serbia. Duke e konsideruar Kosovën ende territor të saj targat u lëshuan edhe me inicialet e qyteteve të Kosovës me ç'rast mendohet se janë dhënë 186 targa për qytetarët e Kosovës.¹³ Duke u konsideruar cenim i sovranitetit, MPB lëshoi një urdhëresë administrative për konfiskim të këtyre targave. Kjo urdhëresë nxiti reagime tek Qeveria Serbe dhe faktori ndërkombëtar (kryesisht EULEX) duke u cilësuar si e njëanshme. Ndërkaq, Ministri për Kosovën në Qeverinë e Serbisë e quajti vendimin si ilegal dhe se “nuk mund të implementohet pa dëshirën që të shkaktohen incidente në veriun e Kosovës të dominuar nga serbët”.¹⁴

Pavarësisht këtyre qëndrimeve dhe thirrjeve për marrëveshje të “heshtur” në formë moratoriumi për targat¹⁵ MPB nuk u tërhoq nga vendimi përkundër presionit ndaj ministrit Rexhepi. PK filloi me ekzekutimin e urdhëresës duke konfiskuar dhjetë targa të lëshuara nga Qeveria e Serbisë. Si rezultat i zbatimit të urdhëresës, dy ditë më vonë vetura e zëvendës komandantit të stacionit policor u dogj.¹⁶ Por, efekti pozitiv ishte ndalja e lëshimit të targave tjera nga Qeveria e Serbisë si dhe mos-lejimi i tyre në territorin e Kosovës.

Përkundër kësaj, mbetet sfidë pajisja e qytetarëve serbë me targat e Republikës së Kosovës duke hequr edhe targat e lëshuara gjatë administratës së UNMIK-ut. Gjatë lëshimit të targave të reja në dhjetor të

¹⁰ Intervistë me z.Besim Hoti zëdhënësi i Policisë së Kosovës për rajonin e Mitrovicës, korrespondencë përmes postës elektronike., 4 mars 2011.

¹¹ Intervistë me Iaan Cohn koordinator për veriun nga EULEX. 23 shkurt 2011.

¹² Policia e Kosovës nuk mbanë të dhëna se sa raste të veturave pa regjistrim ose targa janë gjobitur.

¹³ Intervistë me Fisnik Rexhepin, këshilltar politik në MPB. 18 shkurt 2011

¹⁴ Oliver Ivanovic, Koha Ditore 16 janar 2011

¹⁵ Për të shmangur incidentet qarkulluan informatat për moratorium me ç'rast Serbia do të ndërpret lëshimin e targave tjera ndërsa qeveria e Kosovës nuk do të konfiskoj 186 targat e lëshuara, Koha Ditore,

¹⁶ Bota Sot, Eulex kundër provokimeve.

vitit 2010, Ministri i Punëve të Brendshme pohoi se pajisja me targa të qytetarëve serbë do të zgjasë 3 deri në 6 muaj.¹⁷

FUNKSIONIMI I ZINXHIMIT KOMANDUES NË POLICINË E KOSOVËS

Policia e Kosovës u formua me 6 shtator 1999, duke respektuar parimet demokratike dhe standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe forcimin e sundimit të ligjit. Policia trashëgoi një situatë të rënduar e cila mbretëronte në këtë kohë në fushën e sigurisë. Policia e Kosovës është organ i pavarur i cili punon dhe funksionon nën autoritetin e Ministrisë së Punëve të Brendshme.¹⁸

Bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Ligjin për Policinë e Kosovës, PK ka zinxhir të unifikuar komandues në tërë Republikën e Kosovës, me stacione policore të cilat korrespondojnë me kufijtë komunalë.¹⁹ Kreu III i ligjit për PK, parasheh zinxhir të unifikuar komandues të kësaj force për tërë territorin e Republikës së Kosovës, dhe organizohet në dy nivele, në atë qendror dhe lokal. Në nivelin Qendror përfshin Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë, në kuadër të së cilës funksion i tërë zinxhiri komandues i PK-së. Ndërsa organizimi i PK-së në nivelin rajonal përfshinë Drejtoritë Rajonale të Policisë, Stacionet Policore si dhe Nënstacionet Policore të cilat janë të vendosura nën ombrellën e Drejtorisë së Përgjithshme.²⁰

Zinxhiri komandues i Policisë së Kosovës nuk është unik në tërë Kosovën, sepse policia në veri raporton në Prishtinë përmes EULEX. Forma e komunikimit më pjesëtarët e PK në veri behët nëpërmjet kanaleve të EULEX-it. Andaj shpeshherë ndodhë që urdhrat të cilat jepen nga zinxhiri më i lartë komandues të mos zbatohen nga ana e pjesëtarëve të PK në veri, siç ndodhi konkretisht me z. Milosevic, ish komandantin e njërit nga stacionet e PK-së në veri, i cili kishte bërë shkelje të rënda të detyrave policore, e po ashtu kishte bërë fshehje të veprës penale.²¹ Me fjalë të tjera, Drejtoria Rajonale e Policisë në Mitrovicë mbeti i vetmi regjion ku nuk u bë bartja e përgjegjësive nga prania ndërkombëtare në Policinë e Kosovës, e që cenon pronësinë vendëse në ushtrimin e detyrave për rend dhe siguri.

Kështu vlen të theksohet se pengesa shumë e madhe për funksionimin e zinxhimit komandues brenda PK-së në veri mbetet si pasojë e mosangazhimit të duhur të EULEX si dhe presionit që vjen prej Beogradit zyrtar mbi pjesëtarët e PK në Mitrovicë. Strukturat ilegale në veri të Mitrovicës synojnë që PK të jetë joefektive në luftimin e krimit të organizuar dhe trafikimit duke i shtyrë pjesëtarët serb të PK-së që të jenë neutral ndaj statusit dhe duke i kërcënuar që të mos bashkëpunojnë me PK-në në jug.

Po ashtu ka dyshime që disa pjesëtarë të Policisë së Kosovës në veri janë në të njëjtën kohë edhe pjesëtarë të MUP-it serb dhe marrin paga të dyfishta, si dhe marrin pjesë në mënyrë aktive në takime

¹⁷ Telegrafi, dhjetor 2010.

¹⁸ Raporti i Policisë së Kosovës për vitin 2010, faqe 3

¹⁹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Sektori I Sigurisë Neni 128

²⁰ Raporti i Policisë së Kosovës për 2010,

²¹ <http://www.kohaditore.com/index.php?cid=1,7,52266>

dhe aktivitete të ndryshme të organizuara nga strukturat ilegale që veprojnë atje.²² Përkundër përpjekjeve të shumta nga Qeveria e Kosovës dhe faktori ndërkombëtarë që këta pjesëtarë të integrohen plotësisht brenda strukturave të PK-së, dyshimet për angazhim të dyfishtë të këtyre pjesëtarëve e zbehin suksesin real të këtyre përpjekjeve.²³ Marrë parasysh numrin relativisht të vogël të policëve të vendosur atje (gjithsej 318 policë ku shumica janë të komunitetit serb) krahasuar me territorin që e mbulojnë, nivelin e lartë të aktiviteteve ilegale dhe krimit të organizuar, si dhe mosfunksionimin e gjykatave, atëherë vështirë mund të thuhet se ka përpjekje serioze për vendosjen e rendit dhe ligjit në veri.

Për të ndryshuar këtë gjendje, së voni është filluar me disa veprime konkrete siç janë: patrullimi i përbashkët me përbërje shumë-etnike në kuadër të policisë së trafikut si dhe veprime tjera të përbashkëta në kuadër të fushëveprimit të PK-së.

STRUKTURAT ILEGALE

Edhe më tutje mekanizmat shtetërore të Kosovës për zbatimin e ligjit nuk kanë arritur ta shtrijnë praninë dhe aktivitetin e tyre në tërë territorin e Kosovës (edhe në komunat të cilat përfshijnë edhe Veriun e Kosovës)²⁴ Në anën tjetër, Qeveria e Serbisë në aktivitetet e saj në Kosovë vazhdon të mbështesë strukturat ilegale, duke ju ofruar mbështetje financiare filluar nga gjyqësia, shëndetësia, arsimi si dhe shërbimet tjera komunale. Përveç veprimit të strukturave të MUP-it serb, ka dyshime për një prani edhe të Agjencionit Inteligent të Serbisë – BIA. Këtu duhet përmendur edhe praninë e shërbimit ushtarak të kundërzbulimit dhe funksionimin të vazhdueshëm të komponentës rezervë të ushtrisë bazuar në modelin e kaluar të ish-mbrojtjes territoriale, ku këta pjesëtarë do të mobilizoheshin në “rast se kërkohet”.²⁵ Zhvillimi i këtyre strukturave është bërë shkaktari kryesor edhe për mos sundimin e rendit dhe ligjit në veri të vendit, duke shkaktuar pa siguri për një kohë shumë të gjatë.

Funksionimi i misionit të EULEX-it, në veri të Kosovës ndryshon në krahasim me pjesët tjera, të vendit. Aktivitetet e EULEX-it të bazuara nga parimi Mentorim, Monitorim dhe Këshillim (MMA) për institucionet e Kosovës nuk zbatohen njëjtte tërë territorin e Kosovës sepse në këtë pjesë EULEX ka mandat ekzekutiv. Marrë parasysh rrethanat politike dhe ato të sigurisë misioni i EULEX-it në veri të Kosovës vepron si zbatues i ligjit sesa në kondita të misionit MMA.

Madje shpesh herë qëndrimet e EULEX janë kritikuar nga qarqe të ndryshme vendore për veprime të bazuara në qëndrime të dyfishta dhe selektive. Kështu edhe pse EULEX-i zyrtarisht ka deklaruar se nuk i

²² Këtë fakt e pohojnë zyrtarë Brenda PK si dhe burime të ndryshme.

http://klankosova.tv/index.php?option=com_content&task=view&id=5644&Itemid=99

²³ Interviste me një ish zyrtar të lartë të PK

²⁴ Veriu i Kosovës përfshin komunat e Mitrovicës së veriut, Leposaviqin dhe Zubin Potokun këto komuna ende nuk pranojnë realitetin e ri të krijuar në Kosovë

²⁵ <http://www.botasot.info/def.php?id=102590>

njuh strukturat ilegale dhe nuk ka bashkëpunim me to, vetë strukturat ilegale së voni demantuan këtë fakt duke deklaruar se ndërprejnë bashkëpunimin me EULEX.

Kohëve të fundit janë vërejtur disa nisma drejt shtrirjes së pranisë së institucioneve të zbatimit të ligjit në veri të Kosovës, siç janë patrullimi i njërive speciale të Policisë së Kosovës në veri, konfiskimi i targave te reja të automjeteve serbe dhe patrullat e përbashkëta shumë etnike të policisë së trafikut.

Në veri të vendit funksionon gjykata e EULEX-it ku gjyqtarët dhe prokurorët e saj janë duke hetuar rreth 25 raste kriminale prej të cilave 7 raste janë te profilit të lartë kriminal.²⁶

Vlen të theksohet hapja e zyrës komunale për shërbime civile në veri, nëpërmjet të cilës të gjithë qytetarët kryejnë shërbimet komunale. Interesimi i qytetareve nga të gjitha komunitetet që të pajisen me dokumente kosovare është i mirë që është edhe një paralajmërim tjetër që dëshmon se problemet ndëretnike janë të rralla, por sfidë mbetet zbatimi i ligjit dhe luftimi i krimit të organizuar.²⁷

ANALIZË

Me hyrjen në fuqi të Kushtetutës së Kosovës rendi i ri politik dhe kushtetues në Kosovë filloi të manifestohet përmes zbatimit të ligjeve shtetërore me përjashtim të veriut të Kosovës.

Në mungesë të pranisë së institucioneve vendore, EULEX-i ka përgjegjësi dhe mandat ekzekutiv në veri. Edhe pse EULEX ka mandat ekzekutiv prape ushtron detyrat e veta në bazë të MMA, ky mision dorëzohet në luftimin e krimit të organizuar dhe krijimin e mjedisit të sigurve për gjithë qytetarët.

Aspekt tjetër është dështimi në zbatimin e strategjive dhe nismave tjera të filluara nga institucionet e vendit dhe partnerët ndërkombëtar. Hartimi i strategjisë për veriun e cila synoi krijimin e mjedisit të sigurve për qytetarët serbë dhe komunitetet tjera që jetojnë në këtë zonë por në fakt hulumtimi shumë pak identifikon zbatimin e pikave të synuara të strategjisë dhe si rrjedhojë ky dokument mund të konsiderohet deri në një masë i dështuar.

Në aspekte tjera, ka pasur veprime të kufizuara për përmirësimin e jetës së qytetarëve siç është ndërtimi i shtëpive, megjithatë banorët nuk janë kthyer për shkak se ende mungon siguria e duhur.

Qeveria Serbe pengon në mënyrë aktive shtrirjen e aktiviteteve të institucioneve shtetërore të Kosovës në pjesën veriore të vendit nëpërmjet mbështetjes së strukturave ilegale që veprojnë në Kosovë. Qeveria e Serbisë në nivelin politik e diplomatik shfrytëzon mjaft mirë qeveritë e shteteve që nuk e kanë njohur statusin politik të vendit, për të penguar politikat integruese në veri të Kosovës. Qeveria e Kosovës dhe prezenca ndërkombëtare në Kosovë nuk kanë ndonjë strategji për pengimin e kësaj politike regresive nga ana e Beogradit zyrtar.

²⁶ Intervistë me Iaan Cohn koordinator për veriun nga EULEX. 23 shkurt 2011.

²⁷ Intervistë me z. Avni Kastratin Kryetar i Komunës së Mitrovicës, 21 shkurt 2011

Aktivitetet dhe politikat e Qeverisë që kishin për fokus shtrirjen e autoritetit shtetëror në veri të Kosovës nuk kanë kaluar nëpër debat parlamentar. Këto veprime i ka përcjellë edhe mungesa e madhe e përfshirjes së shoqërisë civile. Kuvendi i Kosovës asnjëherë nuk ka i kërkuar përgjegjësi ekzekutiv të vendit lidhur me zbatimin e strategjisë për veriun. Kjo ka rezultuar edhe në mungesë të transparencës dhe informim të qytetarëve lidhur me aktivitetet e qeverisë dhe faktorit ndërkombëtar rreth integritetit të veriut brenda sovranitetit shtetëror. Si pasojë e mos llogaridhënies rezultoi edhe me ndikimin e Qeverisë së Kosovës në aktivitetet dhe agjendën e parlamentit.²⁸ Në këtë mënyrë, zbatimi i strategjisë për veriun nuk ka qenë proces transparent dhe i hapur për opinionin publik.

Grupe të caktuara të interesit ekonomik dhe politik në veri janë të interesuara në ruajtjen e status-quo-s në veri. Kufijtë e pakontrolluar krijojnë një klimë të përshtatshme për kontrabandim të mallrave nga Serbia në Kosovë dhe anasjelltas, duke krijuar kështu mundësi për përfitim material dhe ndikimit politik për grupet e ndryshme kriminale. Nga raporte të ndryshme besohet se ekziston një lidhje mes grupeve kriminale me strukturat ilegale në veri sikurse edhe me grupet kriminale nga pjesë tjera të Kosovës.²⁹ Për këtë, luftimi i krimit nuk duhet të mendohet vetëm në veri të territorit por të ketë hetime në gjithë Kosovën dhe grupet që kanë lidhje me krimin në veri të luftohen, po ashtu edhe bizneset që stimulojnë kontrabandën duhet të jenë cak i kontrollit nga institucionet shtetërore të zbatimit të ligjit (shembull janë pikat e karburantit).

Bashkësia ndërkombëtare e konsideron Serbinë si ndërmjetësues në zgjidhjen e problemit në veri të vendit. EULEX-i sheh bisedimet mes Kosovës dhe Serbisë si mënyrë e vetme e zgjidhjes së problemeve politike dhe të sundimit të rendit dhe ligjit në veri³⁰ me ç'rast do të definoheshin qartë përgjegjësitë e secilës palë. Edhe Qeveria e Kosovës ka pritje që Serbia të heq dorë eventualisht nga mbështetja e strukturave ilegale të cilat veprojnë në veri.³¹ Ndërkohë, problemi qëndron në atë që Serbia edhe me tutje tenton shtrirjen e sovranitetit në veri dhe nuk mund të luaj rol in e vullnetarit të mirë duke hequr dorë nga veriu i Kosovës. Politika e pritjes se Serbia do të tregoj gatishmëri në shtrirjen e sundimit të ligjit nga autoritetet kosovare dhe EULEX-i ndikon në mungesën e iniciativave substanciale nga EULEX-i dhe më pak nga Qeveria e Kosovës për kthimin e rendit dhe ligjit në veriun e vendit.

Bashkëpunimi dhe komunikimi i stacioneve qendrore dhe rajonale me stacionet policore në veri bëhet përmes EULEX-it. Në këtë rrafsh, EULEX mban të drejtën e zhvillimit të komunikimit me veriun dhe marrjen e vendimeve për veriun. MPB dhe Policia e Kosovës kanë raport sub-ordinues dhe jo partneritet të singertë me EULEX-in.³²

Prioritet i EULEX-it është mbajtjen e gjendjes së qëndrueshme të sigurisë atje dhe evitimi i trazirave të mundshme për shkak të gjendjes së ndjeshme që mbretëron në atë pjesë, dhe të vepohet me hapa të

²⁸ Intervistë me z. Ahmet Isufin, kryetar i Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri në Kuvendin e Kosovës,

²⁹ Raporti I ICG-së, 2011.

³⁰ <http://www.koha.net/index.php?cid=1,22,56200>

³¹ Intervistë me një ish zyrtar të lartë të Policisë së Kosovës.

³² Intervistë me z. Behar Selimi, ish-ushtues i detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë dhe deputet i Kuvendit të Kosovës, 24 mars 2011.

ngadaltë drejtë normalizimit të gjendjes atje.³³ Siguria si shërbim kuptohet në mungesën e trazirave dhe jo më shumë. Ndërkohë siguria është *“gjendja e të qenurit i mbrojtur nga incidentet e planifikuara, qëllimkëqija, dhe kriminale nga një rang i gjerë i kërcënimeve me ç’rast ajo që mbrohet janë të gjitha llojet e vlerave të organizatave/individëve dhe incidentet ndodhin nga dëshira për të një qëllim/pasojë të dëshiruar nga sulmues”*.³⁴

Duke mos krijuar kushtet e duhura për shprehje të lirë të qytetarëve atëherë edhe gjendja e sigurisë mbetet e brishtë. Nga raporti i Grupit Ndërkombëtar të Krizave (ICG) vërehet që një pjesë e MUP-it serb ka planifikon aktivitetet për vënien e mjeteve shpërthyes, organizimn të protestave, dhe krijimin të trazirave që gjendja e sigurisë të mos jetë stabile.³⁵

Skema e veprimeve gjithnjë është e njëjtë: Qeveria e Kosovës dhe shoqëria civile ushtrojnë presion mbi EULEX-in për veprim. Misioni Evropian heziton për shkak të shkakimit të trazirave por edhe nëse vepron MUP-i reagon me vënie të bombave ose krijim të trazirave dhe EULEX tërhiqet. Kjo status-quo vazhdon nga viti 1999 deri më tani.

Për të nxjerrë vendin nga kjo gjendje iniciativa dhe përgjegjësia e veprimit u takon institucioneve të Kosovës dhe pranisë ndërkombëtare. Rasti i konfiskimit të tabelave ilegale serbe dëshmon se nëse institucionet tregojnë vendosmëri atëherë edhe rezultatet nuk mungojnë.

REKOMANDIMET

Ky dokument ka për qëllim që krahas analizës së gjendjes dhe identifikimit të disa sfidave të zbatimit të ligjit në Kosovë, me fokus në veri të vendit, të jep disa rekomandime që i drejtohen institucioneve përkatëse. Mirëpo, një pjesë e rekomandimeve nuk reflektojnë domosdoshmërisht pjesën e analizës kështu që lexuesi nuk mund të gjej shpjegime analitike lidhur me disa rekomandime në brendi të përmbajtjes.

Për Qeverinë e Kosovës

- Prania dhe veprimet e dëmshme të strukturave ilegale përbëjnë një ndër kërcënimet serioze të sigurisë së Kosovës. Institucionet e Kosovës dhe ato ndërkombëtare duhet të bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë ngushtë për të pamundësuar veprimin e strukturave ilegal, duke krijuar kështu kushtet e nevojshme për zhvillimin e jetës normale për qytetarët në veri;

Për Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Policinë e Kosovës:

³³ Intervistë me Alessandro Tedesco, menaxher i programeve nga EULEX-i për shoqërinë civile, 23 shkurt 2011

³⁴ Eirik 7

³⁵ Europe Report Nr.211, International Crisis Group, North Kosovo: Dual Sovereignty in Practice, 14 mars 2011, faqe 5.

- Prania e pjesëtarëve të policisë në veri të vendit është në dis-proporcion me hapësirën gjeografike, numrin e banorëve dhe nivelin shumë të lartë të krimit dhe kundërvajtjeve. Është e domosdoshme që të dërgohen pjesëtarë shtesë të policisë për të vendosur rend dhe zbatim të ligjit në atë pjesë të vendit. Kjo nuk nënkupton “policizimin” e atij territori mirëpo ngritje të gatishmërisë vepruese në përshtatje të rrethanave;
- KFOR nuk duhet të jetë akteri i vetëm që siguron kufijtë në atë pjesë të territorit. Kjo aq më parë që ushtria nuk është më e përgatitur t’i kryej detyrat e kontrollit të kufirit. Në këtë mënyrë, kërkohet fillimi i kontrollit të përbashkët të kufirit në mes të policisë kufitare të Kosovës dhe KFOR-it në mënyrë që të bëhet transferim gradual i përgjegjësive të kjo e para. Fillimi i prezencës së policisë kufitare në vijën kufitare veriore përveç arsyeve praktike do të demonstronte edhe ushtrimin e sovranitetit të institucioneve të Kosovës në atë pjesë;
- Qarkullimi i veturave pa targa dhe me targat të lëshuara nga MUP e Serbisë dhe me iniciale të qyteteve të Kosovës është kundërligjore dhe cenon rëndë integritetin territorial të Kosovës. Kërkohet që policia të vazhdojë konfiskimin e tabelave, duke iniciuar edhe procedurat gjyqësore të parapara më ligj;
- Qendra Alarmuese dhe Koordinuese Emergjente (QAKE) në Mitrovicë, edhe pse e funksionalizuar së fundi, nuk merr informacione fare nga komnatat në veri lidhur me incidentet që ndodhin nga fatkeqësitë natyrore dhe ato të shkaktuara nga faktori njeri. MPB e Kosovës duhet të bëjë përpjekje serioze që komnatat në veri t’i raportojnë kësaj Qendre;
- Drejtorija rajonale e policisë në Mitrovicë është një ndër drejtoritë e vetme që nuk është bërë bartja e përgjegjësive nga prania ndërkombëtare tek vendorët. MPB e Kosovës duhet urgjentisht dhe me këmbëngulësi të merr kompetencat për këtë drejtori më së largu në vjeshtë të 2011;
- Kthimi i pjesëtarëve shqiptarë të doganës së Kosovës në pikat kufitare në veri të vendit, Bernjak dhe Jarinjë, nuk mund të bëhet pa ofrimin e sigurisë fizike për ta. Kërkohet që urgjentisht Policia e Kosovës, EULEX, dhe KFOR të ofrojnë siguri të domosdoshme për këta pjesëtarë;

Për Ministrinë e Drejtësisë

- Funksionalizimi i Gjykatës së Qarkut në veri duhet të jetë një ndër detyrat parësore. Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me EULEX-in duhet me çdo kusht krijoi kushtet për fillimin e punës së kësaj gjykate, përbërjen e saj me gjyqtarë dhe zyrtarë serb dhe shqiptarë të Kosovës, si dhe për ofrimin e sigurisë për këta të fundit;

Për Kuvendin e Kosovës

Nevoja për shqyrtimin e gjendjes në pjesën veriore është urgjente. Kuvendi i Kosovës domosdoshmërisht duhet të mbajë seanca plenare të posaçme për gjendjen e zbatimit të ligjit në Kosovë, e sidomos në veri duke ftuar në interpelancë institucionet përkatëse përgjegjëse;

- Kuvendi i Kosovës duhet të mbajë seanca të posaçme për të ftuar në përgjegjësi EULEX-in për veprimet e tij, që nga dita e parë e operacionalizimit;
- Komisioni Parlamentar për punë të brendshme, siguri dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës duhet në mënyrë periodike të kërkojë llogaridhënie nga organet relevante qoftë lokale apo ndërkombëtare lidhur me gjendjen e sundimit të ligjit në veri;

EULEX

- Dështimi për të ofruar siguri për qytetarët në pjesën veriore të Kosovës e ka përcjellë praninë ndërkombëtare që nga viti 99 e deri më sot. Është urgjente që EULEX të ushtroj përgjegjësitë e veta për të garantuar rend dhe ligj në pjesën veriore. Prania i njëjtit të specializuara të EULEX-it u jep atyre përparësinë që t'i mbështesin përpjekjet e policisë së Kosovës në arrestimin e kontrabanduesve në veri;
- EULEX duhet të ushtroj mandatin e vet në mënyrë të pavarur dhe të pandikuar nga udhëzimet dhe situatat politike, në mënyrë që veprimet e tyre të mos perceptohen dhe vlerësohen si veprime të balancuara dhe selektive.

BIBLIOGRAFIA:

Ligjet dhe Strategjitë:

1. Strategjia për Veriun e Kosovës
2. Kushtetuta Republikës së Kosovës
3. Strategjia e Nacionale kundër Krimit të Organizuar
4. Ligji për Policinë

Raportet artikuj dhe hulumtime :

1. Four steps to security and stability”, 16 korrik 2010, shih: <http://www.eulex-kosovo.eu/en/news/000245.php>
2. De Marnhac, emphasizes the importance of the north of Kosovo, 05 Nov 2010, shih: <http://www.eulex-kosovo.eu/en/news/000266.php>
3. Ęandelin Roth, a special job in Mitrovicë/a, by Hanns-Christian Klasing, 17 gusht 2009, në <http://www.eulex-kosovo.eu/en/profiles/0005.php>
4. Koha Ditore
5. Europe Report Nr.211, International Crisis Group, North Kosovo: Dual Sovereignty in Practice, 14 Mars 2011
6. Bota Sot, Eulex kundër provokimeve
7. Telegrafi, dhjetor 2010
8. Raporti I Grupit Ndërkombëtar te Krizave, Sundimi I Ligjit ne Kosove , Maj 2010 . shih: <http://www.crisisgroup.org/~media/Files/europe/balkans/kosovo/204%20The%20Rule%20of%20Law%20in%20Independent%20Kosovo%20ALBANIAN.ashx>
9. Koha Ditore, Dialogu ngadalëson themelimin e komunës Mitrovica e veriut , 14 mars 2011. Shih: <http://www.kohaditore.com/index.php?cid=1,22,52245>
10. Europe Report Nr.211, International Crisis Group, North Kosovo: Dual Sovereignty in Practice, 14 mars 2011, faqe 5.
11. Shneiere, Beyond Fear, faqe 11

Intervistat me akterët e ndryshëm:

1. Intervistë me Kate Faeron Projekt Manager e ICO për Veriun e Kosovës
2. Intervistë me Z. Fisnik Regjepi Këshilltar i Ministrit të MPB
3. Intervistë me Alessandro Tedesco Program Manager për Shoqërinë Civile në Eulex

4. Intervistë me Z. Ahmet Isufin kryetar i Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri në Kuvendin e Kosovës
5. Intervistë me Z. Besim Hotin Zëdhënës I PK në Mitrovicë
6. Intervistë me z. Avni Kastrati Kryetar i Komunës së Mitrovicës
7. Intervistë me z. Behar Selimin ish Drejtor i përgjithshëm i PK dhe tani deputet i Kuvendit të Kosovës
8. Intervistë me Z. Iaan Cohn koordinator për veriun nga EULEX
9. Intervistë me zyrtar të lartë të të Eulexit.
10. Intervistë me një ish zyrtar të Lartë të Policisë së Kosovës